



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 314, datë 11.5.2022

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME
PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, PËRBËRJEN, KRITERET
DHE PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES, SI DHE SHPËRBLIMIN
E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË START UP-EVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 8, të ligjit nr.25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e *start up-eve*", me propozimin e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të organizimit e funksionimit të Këshillit të *Start up-eve* pranë ministrit përgjegjës për sipërmarrjen, përcaktimi i kriterëve, procedurës së përzgjedhjes dhe rasteve të mbarimit të mandatit dhe të shkarkimit të anëtarëve, si dhe të masës së shpërblimit financiar të anëtarëve.
2. Këshilli i *Start up-eve* ngrihet pranë ministrit përgjegjës për sipërmarrjen dhe ushtron detyrat dhe kompetencat në nxitjen e zhvillimit të *start up-eve*, në përputhje me ligjin nr.25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e *start up-eve*", dhe me dispozitat e këtij vendimi.

II. PËRBËRJA E KËSHILLIT TË START UP-EVE, KRITERET DHE PROCEDURA E PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE

3. Këshilli i *Start up-eve* kryesohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të tjerë të zgjedhur nga institucione të

lidhura me shërbimet e ofruara për biznesin dhe *start up*-et me mandat për një periudhë 1-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje, si më poshtë vijon:

- a) Një anëtar i caktuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, i cili mbulon fushën e sipërmarrjes;
 - b) Një anëtar i caktuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), i cili mbulon fushën e sipërmarrjes dhe inovacionit;
 - c) Një anëtar i caktuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, i cili mbulon fushën e *start up*-eve dhe inovacionit (AKSHI);
 - ç) Një anëtar i caktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI);
 - d) Një anëtar i caktuar nga *GIZ Albania*, i cili mbulon zhvillimin dhe promovimin e *start up*-eve dhe të ekosistemit.
4. Mandati i anëtarit të Këshillit të *Start up*-eve përfundon në rastet e mëposhtme:
- a) Dorëheqje;
 - b) Përfundim i mandatit të qëndrimit në detyrë;
 - c) Mbushje e moshës së pensionit të pleqërisë;
 - ç) Shkarkim;
 - d) Vdekje e anëtarit.
5. Anëtari i Këshillit të *start up*-eve shkarkohet nga detyra në rastet e mëposhtme:
- a) Ndërprerje e marrëdhënies së punës me institucionin që përfaqëson;
 - b) Dënim me vendim penal të formës së prerë;
 - c) Kur bëhet i paafte mendërisht ose fizikisht për të ushtruar detyrën;
 - ç) Mospjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit të *Start up*-eve për më shumë se 1 (një) herë;
 - d) Kur, me veprimet e tij, dëmton veprimtarinë e Këshillit të *Start up*-eve dhe imazhin e institucionit që përfaqëson dhe të institucionit përgjegjës për funksionimin e Këshillit.
6. Në rast vakance në pozicionin e anëtarit të Këshillit të *Start up*-eve, ministri përgjegjës për sipërmarrjen, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga konstatimi i vakancës, njofton institucionin përkatës për propozimin e anëtarit të ri.

Institucioni propozues duhet të zgjedhë anëtarin e ri brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të ministrit.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLIT TË START UP-EVE

7. Këshilli i *Start up*-eve mblidhet, si rregull, çdo 4 (katër) muaj, si dhe sa herë që kërkohet nga kryetari, sipas nevojave të veprimtarisë në fushën e mbështetjes së *start up*-eve.
8. Mbledhja e Këshillit të *Start up*-eve është e vlefshme nëse në të janë të pranishëm, të paktën, 5 (pesë) anëtarë.
9. Mbledhja e Këshillit të *start up*-eve drejtohet nga kryetari.
10. Këshilli i *Start up*-eve, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, asistohet nga sekretariati teknik, i përbërë nga 2 (dy) anëtarë të kabinetit të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

IV. KOMPETENCAT E KËSHILLIT TË START UP-EVE

11. Këshilli i *start up*-eve ushtron këto kompetenca:

- a) Jep kontribut nëpërmjet diskutimit dhe dhënies së mendimeve për politikën ekzistuese në nxitjen e zhvillimit të *start up*-eve dhe ekosistemit;
- b) Dialogon dhe shkëmben pikëpamje për rritjen e ndërgjegjësimit publik për fushën e veprimtarisë së *start up*-eve, si objektivi i këtij këshilli;
- c) Identifikon dhe analizon pengesat kryesore në zhvillimin e *start up*-eve, sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe ofron zgjidhje për reduktimin e këtyre pengesave;
- d) Lehtëson bashkëpunimin “*triple helix*” nëpërmjet dialogut konstruktiv dhe shkëmbimit të pikëpamjeve ndërmjet qeverisë, biznesit (*start up*) dhe akademisë;
- dh) Diskuton dhe konsulton çështje të tjera sipas rendit të ditës ose sipas propozimit të kryetarit;
- e) Diskuton prioritete të përgjithshme të fushës së mbështetjes së *start up*-eve dhe ekosistemit të *start up*-eve në Shqipëri, parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 14, të ligjit nr.25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *start up*-eve”.

12. Në varësi të çështjeve që do të diskutohen, në mbledhjet e Këshillit të *Start up*-eve ftohen pjesëmarrës nga ekosistemi i *start up*-eve, për të dëgjuar diskutimet e anëtarëve të Këshillit të *Start Up*-eve.

V. MASA E SHPËRBLIMIT

13. Shpërblimi i kryetarit dhe e anëtarëve të Këshillit është në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për mbledhje, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) pagesa në vit.
14. Anëtari i *GIZ Albania*-s përjashtohet nga masa e shpërblimit të parashikuar në pikën 13, të këtij vendimi.
15. Shpenzimet për shpërblimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit të *Start up*-eve vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

16. Funkcionimi i Këshillit të *Start up*-eve u nënshtrohet rregullave të parashikuara në legjislacionin për organet kolegjiale të administratës shtetërore, për çështjet që nuk janë të rregulluara posaçërisht në këtë vendim.
17. Ngarkohen ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe institucionet e listuara në pikën 3 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

EDONA BILALI

NR.PROT. 2328/1
DATË 12.5.2022

MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E
SIPËRMARRJES
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË
INVESTIMEVE
AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË
INDUSTRIALE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

